

UDHËZIM
Nr. 137, datë 27.4.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR
DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 26, pika 8, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

I. Qëllimi i udhëzimit:

1. Ky udhëzim ka për qëllim:

a) Të përcaktojë rregullat e zbatueshme, për procedurën e shqyrtimit të kërkesës mbi bazën e të cilave kërkohet dhe jepet e drejta e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë si përmbarues gjyqësor privat.

b) Të përcaktojë mënyrën e hartimit të kësaj kërkesë dhe afatet e shqyrtimit të saj.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit:

a) Ky udhëzim zbatohet ndaj kërkesave të përmbaruesve gjyqësorë privatë për pezullimin e përkohshëm të veprimtarisë, drejtuar ministrit të Drejtësisë.

b) Kërkesa për pezullimin e veprimtarisë do të cilësohet në ato raste, kur përmbaruesi gjyqësor privat çmon se përmbushet një nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 26, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor privat”.

III. Subjektet përmbaruese udhëzohen:

1. Në çdo rast, kur përmbaruesi gjyqësor privat vlerëson se përmbushet një nga kushtet e parashikuara në nenin 26, pika 1, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor privat”, ai paraqet “kërkesë” të arsyetuar, me shkrim, pranë Ministrit të Drejtësisë, si dhe pranë Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

2. “Kërkesa” me shkrim depozitohet përmes shërbimit postar.

3. “Kërkesa”, e arsyetuar me shkrim, që dërgohet nga përmbaruesi gjyqësor privat, përmban kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit, propozimin për caktimin e përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues, nëse kjo kërkesë për pezullim mbështetet në pikën 1, të nenit 26, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” dhe shoqërohet sipas rastit nga dokumentacioni përkatës vërtetues i motiveve/shkaqeve/arsyeve për të cilat ai po kërkon pezullimin e veprimtarisë.

4. Pas administrimit të kësaj kërkesë nga struktura përgjegjëse për rregullimin e profesioneve të lira në Ministrinë e Drejtësisë, i kërkon mendim me shkrim Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, e cila e jep mendimin e saj jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga marrja e kërkesës.

5. Brenda 20 ditëve nga marrja e mendimit me shkrim të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, por jo më vonë se 30 ditë nga administrimi i “kërkesës” nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë vendos mbi miratimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së përmbaruesit gjyqësor privat.

IV. Zbatimi i udhëzimit:

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen përmbaruesit gjyqësorë privatë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, si dhe struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë.

2. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë ngarkohet të njoftojë dhe të orientojë subjektet që përfaqëson për respektimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)